



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

Klos, më 21.07.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: B.O.E, “EA ENGINEERING” Sh.p.k me Nipt: L97522901O & “NDËRTIMI” Sh.p.k me Nipt: K11325002C me adresë: Rruga “Kuvendi Bruçit”, Nr. 24 Burrel, Mat.

* * *

Procedura e prokurimit: “E hapur, e thjeshtuar”

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-33647-06-21-2022.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *"Ndërtim i rrugës së fshatit Xibër Murrize, Njësia Administrative Xibër".*

Fondi limit: 3 620 874 (Tre milion e gjashtëqind e njëzet mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa t.v.sh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 85 datë 27 Qershor 2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të zhvilluar me datë **04.07.2022** këta ofertues:

1. “EA ENGINEERING” Sh.p.k & “NDËRTIMI” Sh.p.k **L97522901O & K11325002C**
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë **3 278 050** lekë pa t.v.sh, dhe **3 933 660** lekë me t.v.sh.
2. “RUÇI” Sh.p.k **K37509982G**
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë (Ska paraqitur Ofertë Ekonomike) lekë pa t.v.sh, dhe _lekë me t.v.sh.
3. “CARA” Sh.p.k **K07729920F**
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë **3 259 500** lekë pa t.v.sh, dhe **3 911 400** lekë me t.v.sh.

Janë të skualifikuar:

1. “RUÇI” Sh.p.k **K37509982G**
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë (Ska paraqitur Ofertë Ekonomike) lekë pa t.v.sh, dhe ____lekë me t.v.sh.

2. “CARA” Sh.p.k

Emri i plotë i shoqërisë

është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë **3 259 500** lekë pa t.v.sh, dhe **3 911 400** lekë me t.v.sh.

K07729920F

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Për Operatorin Ekonomik “RUÇI” Sh.p.k me Nipt: K37509982G si më poshtë vijon:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në tender, rezultoi se Komisioni i Vleresimit të Ofertave KVO konstatoi që operatori ekonomik “RUCI” Sh.p.k nuk është pajtuar me kërkesën e autëritetit kontraktor, pasi brenda datës 04/07/2022 nuk ka dorëzuar dokumenta provues për vetdeklarimin e bërë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit si dhe dokumenta të paraqitur në rrugë elektronike.

Për sa me lart Komisioni i Vleresimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të ligjit Nr:162 datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe të Kreut X, Neni 82 pika 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr:285, datë 19/05/2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik “(I ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuar, vendosi të skualifikoj ofertën e Operatorit ekonomik “RUCI” Sh.p.k.

2. Për Operatorin Ekonomik “CARA” Sh.p.k me Nipt: K07729920F si më poshtë vijon:

Nuk plotëson pikën 6 të **“Kapacitetit Teknik”** ku kërkohet paraqitja e Certifikatave/diplomave, duhet të jenë lëshuar nga institucione publike /private të licensuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr:15/2017 “Për arsimim dhe formimin profesional në R.SH”

Operatori ekonomik në tabelën e plotësuar për stafin e specializuar, ka deklaruar punonjësit me iniciale Sh.K, dhe A.D, me profesion (karpentier) dhe punonjësit me iniciale M.S dhe P.D, me profesion (betonues) të pajtur me diplomë/Certifikat të lëshuar nga Agjencia Shqipëtare e Punësimit me NUIS L21410066G, nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare ëëë.qkb.gov.alk, në seksionin kërkohet për licencë shoqëria AQSCERT shpk me Nipt. L31511026K, rezultoi se nuk disponon licencën me titull “Formim profesional”, pra kjo shoqëri nuk është licencuar për ofrimin e kurseve profesionale sipas ligjit NR.15/2017 “Për arsimim dhe formimin profesional në R. Sh” për profesionet “Karpentier” dhe “Betonues”.

Gjithashtu nga dokumentat e ngarkuar vetë operatori ekonomik “Cara Sh.p.k” shikojmë se certifikatat e trajnimit për dy punonjësit R.A dhe A.D, dëshmojnë që janë trajnuar për specialist i punimeve në lartësi DPI, rënie nga lartësia dhe jo betonues.

Nuk plotëson pikën 7 të “Kapacitetit teknik”, ku kërkohet paraqitja që OE duhet të ketë të paktën minimum 3 (tre) manovrator . Për manovratorët duhet të paraqitet kontrata e punës, dëshmia e drejtimit nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme. OE në formularin përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 ka deklaruar punonjësit me iniciale B.K , A.M dhe Y.P me profesion manovrator, nga dokumentat e ngarkuar vetë nga OE Cara Sh.p.k shikojmë se B.K dhe A.M nuk disponojnë dëshminë e drejtimit nga DPSHTRR për manovrator.

- Nuk plotëson pikën 9 të **“Kapacitetit Teknik”**, ku duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme të cilat duhet të jenë në pronësi ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacion përkatës.

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësi	Sasi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet min15-20 ton	Në pronësi dhe me qera	Copë	1
3	Kamioncina me kapacitet 3.5 – 5 ton	Në pronësi dhe me qera	Copë	1

OE në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit ka deklaruar kamion me targa AA 937 TP, ku nga dokumentat e ngarkuara nga vetë operatori ekonomik CARA Sh.p.k shikojmë se kamioni me tragë AA 937 TP (45000 -14100= 30900 kg) pra nuk plotëson kërkesën për kamion vetëshkarkues me kapacitet minumi 15-20 ton. OE në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit ka deklaruar se kamioncinat me targa AA 936 TP dhe AB 565 CO ku nga dokumentat e ngarkuara nga vetë operatori CARA sh.p.k shikojmë se nuk plotëson kërkesën për kamioncinat me kapacitet 3.5-5 ton.

Për sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, si dhe të Kreut X, Neni 82, pika 2 të Vëndimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vendosi të s’kualifikojë ofertën e Operatorit Ekonomik “CARA Sh.p.k”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë B.O.E, **“EA ENGINEERING” Sh.p.k me Nipt: L975229010 & “NDËRTIMI” Sh.p.k me Nipt: K11325002C** me adresë: Rruga “Kuvendi Bruçit”, Nr. 24 Burrel, Mat, se oferta e paraqitur, prej **3 278 050** (Tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e pesëdhjetë) lekë pa t.v.sh dhe **3 933 660** (Tre milion e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë me t.v.sh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenet 109 dhe 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Ilmi Hoxha